



Republika e Kosovës

- Këshilli Komunal Për Siguri në Bashkësi (KKSB)–

01.Nr. zyrtar/ 2024

23.04.2025

Mbledhje urgjente e KKSB

Në takim prezantuan:

Besim Ilazi, Kryetar i Komunës

Zahir Doda, DKA

Halim Shehu, Stacioni i Policisë-Kaçanik

Fidaim Fazliu-KBI

Fatmir Qaka, EVSB

Bujar Bajra-Sektori i Emergjencave Civile Komunale

Elmihane Malsiu-HANDIKOS

Naim Hysa-Kryqi i Kuq Komunal

Jashar Selimi-Këshilli i Prindërve

Ylber Tusha-Përfajqsues i bizneseve

Shemsedin Abazi-KLSP

Albestrim Rexhepi-FSK

Vedat Dema – Zyra për Barazi Gjinore

Dardan Duraku- MPB/DSB

Milot Sfishta-MPB

Armend Preniqi-IPK

Labinot Sadiku-MPB



Komuna e Kaçanikut

Mnduh Krasniqi-Inspektorati Komunal

Fatlume Guri-Zyra për Informim

Mbledhjen e kryesoi Kryetari i Komunës i cili paraprakisht i përshëndeti të pranishmit dhe prezatoi këto pika të rendit të ditës:

1.Gjendja e sigurisë dhe situata e krijuar pas arrestimeve që janë bërë në Komunën e Kaçanikut

2.Të ndryshme

Kryetari: KKSBB në bazë të planit të punës i mbanë 6 mbledhje të rregullta në vit por që në raste emergjente KKSBB mbanë takime mvarësisht prej situatave të krijuara .

Për sot unë kam ftuar këtë takim që ka të bëjë me situatën e krijuar pas vrasjes së një zyrtari Policorë në Komunën tonë .

Hetimet rreth kësaj vrasje kanë filluar menjëherë nga institucionet e sigurisë ku më vonë ka rezultuar me bastisjen e disa lokacioneve me qrast janë arrestuar 7 persona të cilët janë si të dyshuar dhe të cilët i takojn një grupi të organizuar si Rinia Islame .

Për fillim fjalën ja kisha dhënë Komandantit të policisë në stacionin e policisë në Kaçanik për të na informuar për situatën e sigurisë e përkatësisht për situatën e krijuar pas arrestimeve që janë bërë ditëve të fundit .

Halim Shehu - Ky do të jetë takimi i fundit i imi në këtë këshill pasi që nga nesër do të ndërroj pozitë dhe për fillim deshta të falenderoj të gjithë akterët që kemi bashkëpunuar në ruajtjen e sigurisë qytetare.

Në këtë periudhë kohore nga takimi i kaluar kemi evidentuar gjithsejtë 68 raste ku rasti më i rëndë ka qenë vrasja e Zyrtarit Policorë, Rreshterit Muhamed Lika, rast i cili na ka tronditë tër Kosovën pasi që i ndjeri ka qenë edhe pjestarë i UÇK –së .

Gjykata , Prokuroria dhe Departamenti kundër krimit të organizuar në bazë të hetimeve që kanë bërë kanë arritur që të i prangosin 7 persona si të dyshuar

Apeloj te ju dhe gjithë opinionin publikë që mos të bien pre e informacioneve që dalin nga thashethëmet debatet televizive , rrjetet sociale që japin informacione të pavërteta për rastin, por të u besojnë informacioneve që dalin nga Institucionet që mirren me rastin në fjalë .

Në periudhën në mes dy takimeve kanë ndodhur 8 vjedhje , vjedhje te rënda 11 raste , kanosje 10 raste , lëndime të lehta trupore 6 raste , posedim i pa autorizuar i mjeteve narkotike 6 raste, dhunë në familje 4 raste , ndërhyrje në sistemet kompjuterike 1 rast , shantazh 1 rast , 5 raste janë sulme , 1 rast armë mbajtje pa leje , shpërdorim i pasurisë së huaj 2 raste , fallsifikim i parasë 1 rast , incident zjarri 1 rast , 1 rast ngacmim , shkaktim i rrezikut të përgjithshëm 1 rast, keqpërdorim i kartelave bankare 1 rast .

Në përgjithësi situata është e mirë ku përjashtim bënë rasti i fundit ku në popullatë është përhapë një panikë e që mundë të them se nuk ka çka krijohet kjo panikë ngase situatën e kemi nën kontrollë dhe çdo gjë po shkonë sipas planit operativ.

Fidaim Fazliu - Falenderoj Kryetarin që e ka marrë këtë hap për këtë takim pas situatës së krijuar me rastin e vrasjes së rreshterit Muhamet Lika , një humbje e madhe për familjen , Policinë e Kosovës , Kaçanikun dhe mbarë Kosovën ngase Muhametin e kemi njohur si njeri të ndershëm e guximtarë .

Ne si Bashkësi Islame jemi të indinjuar dhe shprehim keqardhje që Kaçanikut historik po i ipet padrejtësisht një epitë i një vendi jo të sigurtë .

Ne si Bashkësi Islame vazhdimisht në takimet e këshillit kemi ngritë shqetësimet tona për veprimet e një grupi të cilët nuk kanë të bëjnë me fenë që e praktikojmë , njëherit përgëzoj organet e sigurisë për veprimet që kanë ndërmarrë kohëve të fundit dhe urojë që dorasi të gjindet e të marrë denimin e merituar .

Unë besoj se organet e sigurisë kanë pasur informacione edhe më herët për veprimet e këtyre grupeve ngase kanë dalur edhe publikisht në rrjetet sociale me aktivitetet e tyre që kanë ndikuar në rekrutimin e të rinjëve .

Duhet të veprohet në vazhdimësi në kapjen e udhëheqësve të tyre ngase ata janë që i udhëzojnë në drejtime të gabuara .

Unë kam vërejtje edhe tek Policia të cilët kanë qenë të informuar nga ne se ky grup po krijonë probleme të natyrave të ndryshme në Xhami por që veprimet e Policisë nuk kanë qenë të duhura .

Apeloj tek mediat që të na kursejnë me shkrimet e tyre alarmante ngase qytetarët e Kaçanikut nuk e meritojnë një epitë që ata ja kanë dhënë .

Kryetari - Nga ky takim ne do të dalim me një komunikatë para qytetarëve se situata nuk është aq alarmante siq po e japin disa media por që ne duhet të jemi syqelë , me një bashkëpunim të vazhdueshëm me akterët e sigurisë që të parandalojmë çdo dukuri që rrezikon jetën qytetare .

Në takimet e këshillit për siguri Kryetari i Bashkësisë Islame shpeshë e ka paraqitë si problematike veprimin e disa personave në Xhami e gjithashtu edhe Komandanti i Policisë ka raportuar për veprimet në bazë të kompetencave që kanë pasur por që është për keqardhje që duhet të ndodhë një rast e veprimet e organeve të sigurisë të intensifikojnë veprimet e tyre .

Më 1 Prill është flijuar nga jeta një Zyrtarë Policorë ku për ne është cenuar siguria qytetare andaj apeloj tek organet e dretësisë që sa më shpejtë të gjejnë dorasin dhe të i japin dënimin e merituar .

Apeli im është edhe për qytetarët që të mos krijojnë panikë , mos të bijnë pre e dezinformatave të ndryshme që po ipen në media dhe rrjetet sociale por të ju besojnë informatave që dalin nga organet e Sigurisë dhe Drejtësisë .

Vedat Dema - Më intereson të dijë në lidhje me këtë grupin Rinia Islame në Kaçanik se a është organizatë e regjistruar pranë një institucioni .

Fidaim Fazliu - Ky grupacion në muajin Ramazan ka kryer disa aktivitete humanitare në muajin Ramazan në emër të Rinisë Islame në Kaçanik dhe unë i kam njoftuar institucionet pasi që ata këto aktivitete i kanë kryer në hapësirat e Xhamisë por që nuk kanë pasë të bëjnë me aktivitetet e Bashkësisë Islame se a janë të regjistruar si OJQ këtë unë nuk e di .

Fatmir Qaka - U tha se operacioni i Policisë ka qenë i suksesshëm dhe pyetja ime për Komandantin e Policisë është se a ka pasur koordinim gjatë operacionit dhe a është bërë ndonjë gabim gjatë këtij operacioni ngase ka informacione se në dy lokacione bastisja ka rezultuar gabim dhe ka krijuar frigë e panikë në ato familje .

Inspektorati i Policisë mirret edhe me ankesat e qytetarëve ndaj Zyrtarëve Policorë dhe nuk përjashtohet mundësia që ata të ankohen .

Halim shehu - Deshta të ju përgjigjem Kryetarit të Bashksisë Islame se lëvizja e lirë e qytetarëve është e pranueshme. Aktivitetet e këtij grupacioni vëzhgohen dhe gjithëherë janë nën përcjellje të Policisë .

Ndërsa sa i përket pyetjes se a ka pasur koordinim gjatë operacionit të arrestimeve, ne si stacion i policisë nuk kemi marrë pjesë ngase ky operacion është kryer nga njësitë Policore të nivelit qendrorë .

Jam i njoftuar se gjatë këtij operacioni ka pasur edhe gabime siq është rasti i Muharrem Qakës i cili është ankuar dhe ne jemi duke u marrë me këtë ankesë .

Fidaim Fazliu - Është një person që nuk është i anës tonë e i cili ka mbajtur burg për aktivitete jashtë ligjore dhe pas lirimit nga burgu ka mbajtur tubime në anën tonë e poashtu ka shpërndarë mesazhe në rrjetet sociale .

Më intereson të dijë që ky person a e ka të ndaluar që të bëjë aktivitete fetare .

Halim Shehu - Normal me aktvendim të gjykatës këtyre personave ju ndalohet të organizojnë tubime dhe aktivitete fetare .

Fatlume Guri - Ky grupacion qenka aktiv në rrjetet sociale dhe ka mbi 10,000 anëtarë .

E kanë një llogo të organizatës por që institucionet duhet me pas informacione se a janë të regjistruar .

Fatmir Qaka - OJQ - të regjistrohen në departamentin e OJQ - ve pranë MAPL dhe posedojnë qertifikatë të regjistrimit .

Ky grupacion nuk përkrahet por as që kemi pas ndonjë rast të përkrahjes së tyre apo një bashkpunim në aktivitetet rinore në Komunën tonë .

Halim Shehu - Mendoj se është një grupacion shumë i vogël dhe që nuk kanë ndikim në Komunën e Kaçanikut .

Një lajm që ka qenë më herët se mbi 80 persona në Komunën e Kaçanikut kanë marrë pjesë në luftën e Sirisë është një gënjeshtër dhe unë shpesh nëpër takime të ndryshme e kam demantuar .

Fidaïm Fazliu – Një shqetësim që e kam ngritë edhe më herët ku në ditën çlirimit të Kaçanikut kanë bërë kërkesë Institucionet për ngritjen e Flamurit Kombëtarë në minaren e Xhamisë si pikë më e lartë dhe unë e kam miratuar me gjithë dëshirë këtë kërkesë por që pjestarë të këtij grupi dy herë e kanë hjekë flamurin dhe më brengosë fakti se nuk është marrë asnjë masë ndaj tyre edhe pse veprimi i tyre është njoftuar në Polici .

Disa prej të arrestuarve kanë qenë të akuzuar edhe për sulm ndaj Gjykatës por që ata janë liruar si të pafajshëm dhe presin që të kompenzohen nga Shteti .

Halim Shehu - Rasti i sulmit ndaj Gjykatës është ende i hapur dhe nuk është mbyllur sipas Prokurorisë ndërsa prononcimet e Avokatëve para mediave nuk janë zyrtare ngase ata e kanë punë për të mbrojtur klientët e tyre .

Kryetari - Rasti i largimit të flamurit nga minarja më ka brengosë edhe mua si Institucion dhe këtë e kemi biseduar edhe në një takim dhe përgjigjja e Komandantit ka qenë që Xhamia është Institucion fetarë dhe nuk mundë të valoj flamur tjetër kinse ka qenë arsyeja e tyre kur janë marrë në biseda informative .

Fidaïm Fazliu – Xhamia është Institucion fetarë dhe aty ka zyrtarë që punojnë në këtë Institucion jo me vendosë një individ që nuk është pjesë e këtij Institucioni .

Nuk bën që të neglizhohen veprimet e këtyre individëve ngase ka ndodhë edhe një rast për muajin e ramazanit që 15 ditë na e kanë uzurpuar edhe një xhami dhe prapë nuk është marrë asnjë masë ndaj tyre .

Fatmir Qaka – Institucionet duhet të interesohen rreth veprimtarisë të këtij grupacioni , kush i financon çfarë aktivitete bëjnë dhe kujt i japin llogari për ato shpenzime që i bëjnë .

Institucionet e nivelit qendrorë të interesohen se a është ky grupacion i regjistruar në Departamentin e OJQ - ve .

Labinot Sadiku – Jam zyrtarë nga MPB si monitorues i KKSB - ve dhe siq e dini KKSB - të në takimet e tyre ngrisin shqetësimet e qytetarëve për sigurinë e tyre .

Është shqetësuese raportimi i Kryetarit të Bashkësisë Islame për disa raste e mos veprimi i policisë .

Është duke u punuar në një strategji që qytetari të bëhet aktiv por që edhe policia të jetë aktive.

Pyetja ime për Komandantin e Policisë është se a janë adresuar shqetësimet e Kryetarit të Bashkësisë Islame dhe ku janë adresuar këto shqetësime .

Halim Shehu - Rastet janë adresuar në stacion Policorë e më pas janë përcjellë në prokurori.

Labinot Sadiku - Në kuadër të policisë është edhe Drejtoria antiterrorizëm dhe besoj se kjo Drejtori ka bashkëpunim edhe me stacionet e policisë nëpër Komuna. Poashtu bashkëpunimi duhet të jetë edhe me KLSP - të që janë të formuara nëpër Komuna.Me ne është edhe përfaqësuesi i divizionit për parandalim i cili ka punuar edhe në këtë pjesë e me siguri se do të na tregoj për punën e këtij divizioni .

Do të interesohem në MAPL nëse ky grupacion është i regjistruar në departamentin e OJQ - ve dhe do të ju informoj .

Arben Vrajolli - Jam nga IPK - Divizioni për Bashkëpunim dhe Informim .

Ndëgjova me vëmendje kët diskutim dhe kjo është arsyeja e këtij forumi për të shkëmbyer informacione me qëllim të mirë për sigurinë qytetare .

Secili nga ne duhet të i marrim përgjegjësitë që na takojnë për të i eliminuar dukuritë negative që shfaqen në komunitet.

Ne si IPK jemi një institucion që mbykqyrim punën e policisë së Kosovës dhe ankesat e qytetarëve për neglizhencë të zyrtarëve policorë për punën e tyre drejtohen tek ne ku më pas shqyrtohen ato ankesa .

Ankesat mundë të bëhen edhe ne Web.faqen tonë të cilat mundë të jenë edhe anonime .

Ne kemi njësitin e inspektimit dhe të hetimit ku përmes tyre ne duke u bazuar në një ankesë inspektojmë dhe hetojmë rastet .

Milot Sfishta - Jam zyrtarë në MPB dhe punojë në fushën e parandalimit dhe riintegritimit .

Në fushën e parandalimit ne po punojmë duke u bazuar në strategjinë e re 2023 - 2024 dhe kemi mbajtur disa takime informuese edhe në Komunën e Hanit të Elezit dhe Kaçanikut .

Është shqetësuese fakti se shumë të rinjë janë të përfshirë në këto grupe radikale.

Ne takimet do të i orientojmë në ato shtresa që ndikojnë për të mirë tek të rinjët siq janë këshillat e prindërve , nxënësve dhe mësimdhënësve .

Në Komunën e Hanit të Elezit është krijuar një mekanizëm lokal referues dhe ju sugjeroj ta krijoni edhe këtu duke e caktuar një ekip që do të trajnohet për funksionalizimin e këtij mekanizmi .

Kryetari - Ne si Komunë kemi qenë shumë bashkëpunues në këtë drejtim duke marrë pjesë në takimet që ka organizuar niveli qendrorë por edhe institucionet ndërkombëtare dhe më brengosë fakti që nuk është marrë asnjë veprim konkret për të ndihmuar Komunën tonë .

Jam i zhgënjyer me disa veprime që bëjnë disa OJQ të cilat thirrin takime mbajnë një ligjëratë dhe asgjë konkrete nuk ka, andaj edhe kam filluar të i refuzoj takimet e tilla .

Shemsedin Abazi – Jetoj në pjesën ku ka ndodhur vrasja e policit dhe dua të ju informoj se tek banorët e kësaj lagje është krijuar një panikë e madhe .

Ata kanë një kërkesë për institucionet Komunale që të dalin në teren e ta vlerësojnë gjendjen e këtij tereni që krijon pasiguri tek qytetarët të cilët jetojnë në këtë pjesë .

Mbrapa ndërtesës ku ka ndodhur vrasja tereni të krijon pasiguri ku ka edhe mungesë të ndriqimit .

Banorët kanë bërë edhe një kërkesë me shkrim të cilën kërkesë do e dorëzojnë në Komunë .

Kryetari - Kërkesën e banorëve do e shqyrtojmë dhe do të marrim masa me kapacitetet që i kemi mirëpo duhet të egzistoj besueshmëria e qytetarëve për të raportuar rastet .

Kërkesë kemi edhe nga stacioni i policisë për vendosjen e kamerave në vendet kyqe por që edhe kjo nuk është zgjidhje nëse nuk kemi mirëbesim për të bashkëpunuar .

Zahir Doda - Pjesa dërrmuese e të arrestuarve janë të rinjë dhe deshta të japë një rekomandim në lidhje me disa projekte që organizojnë OJQ të ndryshme të cilat në shum raste edhe po e keqpërdorin parandë publike .Pra mos të keqpërdoret paraja publike që për fat të keq kjo po ndodhë në Kosovë përmes disa OJQ-ve të cilat nuk janë serioze në implementimin e projekteve të tyre.

Trajnimet ligjëratat që mbahen nëpër Shkollë e që organizohen në bashkëpunim me Policinë apo FSK - në kanë më shumë efekt dhe ndryshe vlerësohen nga rinia shkollore .

Labinot Sadiku – Ne si Institucione të nivelit qendrorë do i nxjerrim disa rekomandime nga ky takim por që edhe kërkesat që i keni tjera për MPB dhe agjensionet pranë kësaj Minsitrie ne mundë të i përcjellim tek organi kryesor i kësaj Ministrie .

Pajtohem edhe me Drejtorin e Arsimit për rekomandimin që e dha lidhur me aktivitetet e disa OJQ - ve

që po e keqpërdorin parandë publike .

Gjithashtu sugjeroj që edhe në KKSB jo çdo kush të jetë pjesë e këshillit ngase ne me një strategji të re po mendojmë të ofrojmë një bazë të mirëfilltë ligjore me qëllim të avansimit dhe funksionimit të këtij këshilli .

Qëllimi nuk është që të fokusohemi vetëm në statistika por të punohet në gjëra konkrete .

Kryetari - Nga ky takim ne po dalim me një komunikatë që qytetarët të i ulin shqetësimet e tyre dhe mos të bien pre e disa informacioneve të rrejshme .

Të ngritet niveli i bashkëpunimit në mes qytetarëve dhe organeve të sigurisë në parandalimin e çdo dukurie që cënon sigurinë qytetare dhe urojmë që raste të tilla të mos përsëriten .

Rekomandimet

1.Qytetarët të mos bien pre e informacioneve që dalin nga thashethëmet , debatet televizive , rrjetet sociale që japin informacione të pavërteta, por të ju besojnë komunikatave që dalin nga institucionet përkatëse shtetërore .

2.Të mirren veprime konkrete për parandalimin e çdo dukurie që cënon sigurinë qytetare .

3.Të krijohet fryma e bashkëpunimit në mes qytetarëve dhe Policisë në parandalim të dukurive negative

4.Mediat të mos japin lajme alarmante duke i dhënë qytetit tonë një epitete që nuk e meriton .

5.Organet kompetente të e përcjellin aktivitetin e disa grupacioneve të cilët janë si të dyshuar .

6. Çdo neglizhencë e Policisë për shërbim ndaj qytetarëve të adresohet në formë ankese në Web faqen e IPK.

7.Të rregullohet sistemi i ndriqimit në disa pjesë të qytetit .

8.Të ndalohen disa projekte të OJQ - ve të cilat e keqpërdorin paranë publike .

Kryesoi – Kryetari

z.Besim Ilazi



Procesmbajtës

Fatmir Qaka